

Për:	Operatori Ekonomik: Letamed SH.P.K., Nebih Hodo Kuci, 23000, SUHAREKE Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	28.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **28.04.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Letamed SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Blerje e karrigeve stomatologjike**, me Numër të prokurimit: **623-25-1239-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-012-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Letamed SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Blerje e karrigeve stomatologjike**, me Numër të prokurimit: **623-25-1239-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-012-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **24.04.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-25-1239-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-012-1-2-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Letamed SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Blerje e karrigeve stomatologjike**, me Numër të prokurimit: **623-25-1239-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-012-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **24.04.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **28.04.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II.
Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Operatori ekonomike duhet të dorëzojë Autorizim nga prodhuesi apo nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi;

Dëshmia 2: Te dëshmohet se Operatori Ekonomik është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi i cili duhet të përmban Titullin e tenderit dhe numër të prokurimit si me lart, (me të dhëna detaje të kontaktit për prodhuesin ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi adresë, websajti, numri i telefonit, emali);

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operator Ekonomik, **NUK** keni dorëzuar: **Autorizim nga prodhuesi apo nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi, ku dokumenti në fjale nuk mund të kërkohej në bazë të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive;**

Andaj oferta juaj konsiderohet e **papërgjegjshme konform LPP-së;**

Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Në arësyen e eliminimit të ofertës sonë, AK ka cekur që:

Në ofertën tuaj të dorëzuar **NUK keni dorëzuar: Autorizim nga prodhuesi apo nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi**. Kjo fare nuk qëndron se në si Operator Ekonomik përveq se kemi **AUTORIZIME të PERGJITHSHME** nga Prodhuesi, për secilën procedurë të prokurimit kur ofertojmë para datës së dorëzimit të ofertave e pranojmë edhe **AUTORIZIMIN** me emër të projektit, ashtu siq është kërkuar me FDT.

Të njëjtin Autoriteti Kontraktues, konform nenit 72 pika 2 e LPP-së dhe nenit 10 të Udhëzuesit 001/2023, ka mundur të na kërkojë apo të sqarojë situatën.

Këtë autorizim po ja bashkangjesim kësaj kërkesë për rishqyrtim.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Pretendimi juaj është i pabazuara, pasi që edhe në Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, kemi cekur bazë Ligjore, ku dokumenti në fjalë nuk mund të kërkojë në baze të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive;*

Në Udhëzuesi Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, tek faqe Nr. 40: Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, *ceket:*

Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar	Mund të kërkojnë informata sqaruese	66
--	-------------------------------------	----

Nga Udhëzuesi në fjalë **NUK** ceket se Autoriteti Kontraktues, mund të kërkojë nga Operatori Ekonomik plotësimin e ofertës për të kërkuar të dorëzuar Autorizimin, sepse nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive sipas Nenit 72 dhe është në kundërshtim me Dosjen e Tenderit, ku në Nenin 4.1 të FDT-së

Variantet	4.1	Variante autorizohen: Jo ☒
-----------	-----	--

Pretendimi juaj në këtë pikë **është i pabazuara**.

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Për të vërtetuar pretendimet tona se AK qëllimisht na ka eliminuar ne si OE më I lirë dhe ka favorizuar një OE me çmimin më të lartë, ne kemi bërë një analizë të fituesit të këtij projekti.

Meqense jemi OE që punojmë gjatë në këtë fushë, ne pretendojmë se AK ka rekomanduar një OE I cili nuk ka plotësuar kërkesën e FDT-së:

[Kërkesa 4](#) Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) si qarkullues me shumicë pajisjeve medicinale;

[Dëshmia 4](#) Kopja e licencës valide nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM);

OE I rekomanduar, përveq që nuk figuron në Listën e OE të licensuar për produkte dhe pajisje medicinale (verifikimi mundë të bëhet nga secila palë), e të cilin ju e keni rekomanduar për kontratë, PIKËRISHT për këtë kërkesë kishte dorëzuar një ankesë në OSHP (ankesën e keni publike në platformë), në mënyrë që ky kriter të hiqet, qka e vërteton pretendimin tonë se I njëjti nuk e ka licensën për pajisje dhe produkte medicinale edhe nëse fare nuk verifikohet në Listën e të licensuarve.

Pra AK në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 69 dhe 72 të LPP-së, na ka DISKRIMINUAR ne si OE me çmimin më të ulët dhe ka favorizuar një OE, të pa përgjegjshëm, pa License valide (siq është kërkuar me FDT) dhe me çmimin më të lartë, ku ka ka dëmtur buxhetin duke e rekomanduar për fitues këtë OE.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Pretendimi juaj është i pabazuara, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, e ka plotësuar Kërkesë Nr. 4 të Kapaciteti teknik dhe professional:

[Kërkesa 4:](#) Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) si qarkullues me shumicë pajisjeve medicinale;

[Dëshmia 4:](#) Kopja e licencës valide nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM);

Ju si Operator Ekonomik **para Kërkesë për Rishqyrtim, keni mundur të kërkonit Qasje në dokumentacion për të verifikuar se Operatori Ekonomik është i Licencuar nga AKPPM;**
Për korrektësi po ju bashkangjes Licencën nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) për Operatori Ekonomik të Rekomanduar për Kontratë.



Licencë veprimtare

Zv. Kryeshef Ekzekutiv
ACEO
Mr. Arian Ahmeti



Sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) është kërkuar:

Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë ;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, validiteti e tenderit e keni bërë për një periudhë prej: 60 ditë,

Jo në një periudhë: 90 ditë, sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) ;

Formulari i dorëzuar nga ana juaj:

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ
--	--	---------------------

Oferta konsiderohet e **papërgjegjshme konform LPP-së;**

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>